



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Mbledhje e përbashkët e Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut dhe Komisionit për Politikën e Jashtme

PROCESVERBAL

Tiranë, më 21.03. 2019, ora 09:30

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin teknik 2017 për projektin “Zhvillim i qëndrueshëm i zonave rurale”.

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Klotilda Bushka, Elena Xhina Adnor Shameti, Bashkim Fino, Jurgis Çyrbja, Spartak Braho, Mimi Kodheli, Elona Hoxha, Ervin Bushati, Eglantina Gjermani, Ditmir Bushati, Evis Kushi, Vasilika Hysi, Andrea Marto, Alket Hyseni, Rudina Hajdari,

Mungojnë: Reme Lala, Fatmir Xhafaj, Edmond Leka, Damian Gjiknuri, Tom Doshi

Të ftuar:

Ermira Gjeçi – Zëvendësministre e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Elisa Teneqexhi – Drejtore e Drejtorisë së Konceptimit dhe Fizibilitetit të Projekteve në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Pjerin Shoshi – Drejtor i Programeve të Zhvillimit të Bujqësisë, Sigurisë Ushqimore dhe Zhvillimi Rural në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

HAPET MBLEDHJA

Ulsi Manja – Mirëmëngjesi!

Fillojmë mbledhjen e komisionit për ditën e sotme. Në bazë të nenit 47 të Rregullores, mbledhja e komisionit do të jetë një mbledhje e përbashkët ndërmjet Komisionit për Çështjet Ligjore dhe Administratën Publike dhe Komisionit për Politikën e Jashtme. Të dyja komisionet janë për dhënie mendimi. Do të diskutohet e njëjta marrëveshje “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin teknik 2017 për projektin “Zhvillimi i Qëndrueshëm i zonave rurale”.

Kemi caktuar një relator të përbashkët të kësaj marrëveshjeje.

Ka konfirmuar pjesëmarrjen nga Ministria e Bujqësisë zonja Ermira Gjeçi, zëvendësministre.

Zonja Gjeçi, mirë se keni ardhur!

Do t’ju lutesha të na bëni një prezantim të shkurtër të kësaj projekt marrëveshjeje për kolegët e mi të komisionit.

Më pas kemi pyetje, diskutime dhe në fund do ta votojmë këtë marrëveshje, sepse, po sot, kjo marrëveshje do t’i kalojë seancës plenare.

Mbledhja është lënë për ditën e sotme, sepse të dy drejtuesit e komisioneve do të kenë një axhendë parlamentare jashtë Republikës së Shqipërisë.

Fjala është për ju.

Ermira Gjeçi – Faleminderit!

I nderuar kryetar,

Të nderuar deputetë,

Është një financim prej 2 milionë eurosh nga qeveria gjermane dhe pala implementuese në formën e një granti. Angazhimi i qeverisë është rimbursimi i TVSH-së me një fond prej 200 mijë eurosh dhe ka një afat kohor prej dy vjetësh, krahasimisht me një shumë prej 8 milionë eurosh, që është një shtesë nga qeveria gjermane negociuar në fund të vitit 2018 në kuadër të këtij projekti.

Më 27 dhjetor të vitit 2018 u nënshkrua marrëveshja për bashkëpunim teknik mes Këshillit të Ministrave, përfaqësuar nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, dhe qeverisë Federale të Republikës së Gjermanisë.

Në nëntor 2018 është zhvilluar takimi negociues për zhvillimin e bashkëpunimit mes Shqipërisë dhe Gjermanisë, ku qeveria gjermane mori angazhim me një shtesë financimi në shumën 8 milionë euro të tjera për këtë projekt.

Pala shqiptare, si kosto bashkëfinancimi, angazhoi mbulimin e vlerës për rimbursimin e TVSH-së me një vlerë rreth 200 mijë euro.

Ky financim do të adresojë sfidën e konsolidimit dhe orientimit të bujqësisë shqiptare drejt një bujqësie më konkurruese dhe, në të njëjtën kohë, do të mundësojë një sipërmarrje aktive në sektorët jobujqësorë si agroturizmi dhe turizmi rural.

Projekti ka 4 shtylla kryesore në të cilat fokusohet. Është kryesisht asistencë teknike.

Shtylla e parë është implementimi i strategjisë dhe politikave për zhvillimin rural; mbështetje për zhvillimin e strategjive dhe politikave në përputhje me kërkesat e BE-së dhe duke rritur përthithjen e fondeve të IPARD-it.

Shtylla e dytë është promovimi i zinxhirit të vlerës së produkteve tipike të zonave të caktuara. Me këtë nënkuptohet përzgjedhja e produkteve tipike, për të cilat ka edhe kërkesë tregu.

Shtylla e tretë është përmirësimi i edukimit dhe forcimi i dijeve në bujqësi dhe turizëm rural. Përfitues është Agjencia e Pagesave, si dhe Universiteti Bujqësor i Tiranës.

Shtylla e katërt është rritja e kapaciteteve dhe njohurive në bujqësi dhe zhvillimin rural; mbështetje ndaj shërbimit këshillimor, shoqërisë civile, organizatave e të tjerë, me fokus inovacionin në bujqësi. Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Gjeçi!

Fjalën po ia kaloj relatorit, zotit Çyrbja, për të bërë një prezantim të shkurtër të kësaj projekt marrëveshjeje.

Jurgis Çyrbja – Faleminderit!

Qëllimi kryesor i kësaj marrëveshjeje është financimi i projektit të zhvillimit të qëndrueshëm të zonave rurale duke forcuar më tej bashkëpunimin financiar ndërmjet

Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Gjermanisë, me qëllim kontributin e mëtejshëm të Gjermanisë në zhvillimin social dhe ekonomik të Republikës sonë.

Për sa i përket këtij projektligji, ai është në përputhje me Kushtetutën dhe Rregulloren e Kuvendit.

Në këto kushte, u kërkoj kolegëve ta miratojnë këtë projektligj.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Çyrbja!

Ka pyetje nga kolegët e të dyja komisioneve për përfaqësuesin e qeverisë? Nuk ka. Diskutime? Nuk ka as diskutime.

Atëherë e hedhim në votim në parim. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet në parim projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin teknik 2017 për projektin “Zhvillimi i qëndrueshëm i zonave rurale”.

Kalojmë në votimin nen për nen.

Neni 1. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet!

Neni 2. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet!

E hedhim në votim në tërësi marrëveshjen. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet edhe në tërësi kjo projekt marrëveshje!

Relatori dhe këshilltarët e komisionit të bëjnë një raport të përbashkët sipas nenit 27 të Rregullores së Kuvendit dhe t'i dërgohet seancës plenare po sot për votim.

Këtu e mbyllim mbledhjen e komisionit për ditën e sotme!

Faleminderit dhe ditë të mbarë!

MBYLLET MBLEDHJA